VENDIM
Nr. 249, datë 11.12.2018

MBI MIRATIMIN E "PROPOZIMI I GJITHË OST-ve PËR NJË METODOLOGJI TË OFRIMIT TË TË DHËNAVE TË GJENERIMIT DHE NGARKESËS, NË PËRPUTHJE ME NENIN 17 TË RREGULLORES SË KOMISIONIT TË BASHKIMIT EVROPIAN (BE) 2016/1719 TË DATËS 26 SHTATOR 2016 PËR KRIJIMIN E NJË UDHËZUESI MBI ALOKIMIN E KAPACITETEVE NË AVANCË"

Në mbështetje të neneve 7, 16, 56 dhe 63, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, neneve 117; 118–130 të Kodit të Transmetimit të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017; nenit 17 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016; nenit 26 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, mbi miratimin e "Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2016/1719 të datës 26 Shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 237, datë 2.11.2018, ka filluar procedurën për miratimin e "Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë."
- ERE me shkresën nr. 55/68 prot., datë 7.11.2018 ka bërë njoftimin e fillimit të kësaj procedurë në median e shkruar si dhe me shkresën nr. 422/5 prot., datë 2.11.2018, ka përcjellë njoftimin e fillimit të procedurës pranë palëve të interesit.
- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, përkatësisht neni 56 dhe neni 63, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me vendim të Bordit të ERE-s nr. 186, datë 10.11.2017, përkatësisht neni 117 "Kërkesa të përgjithshme për shkëmbimin e të dhënave", si dhe nenet 118 deri 130 të tij. Propozimi është përshtatur në shqip nga Operatori i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike (OST sh.a.) në përputhje me nenin 19 të dokumentit origjinal.
- Dokumenti vjen nga OST sha në vijim të komunikimit nr. 3886 prot., datë 25.5.2018 me objekt: "Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 18 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 20.8.2018 dhe është pjesë e të njëjtit kuadër metodologjik të Metodologjisë së Modelit të Përbashkët të Rrjetit, por i paraqitur dhe propozuar për miratim si akt më vete.
- Dokumenti i përbërë nga 19 nene, saktëson kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës së nevojshme për të krijuar modelin e përbashkët, nëpërmjet të cilit do të bëhet në nivel evropian analiza e sigurisë me qëllim përcaktimin e kapaciteteve të lira në avancë por edhe ato të ditës në avancë apo brenda ditës.
- Në përputhje me vendimin e marrë nga ENTSO-E dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet joanëtar i Bashkimit Evropian, inkurajohen gjithashtu që ta përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përkthim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë "Propozimin e të gjitha OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit të Bashkimit Evropian (BE) 2016/1719, të datës 26 shtator 2016, për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë". (Bashkëlidhur këtij vendimi.)
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë.

Të gjith OST, duke marrë parasysh sa vijon:

ndërkohë:

1) Ky dokument është një propozim i përbashkët i krijuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmisionit (më poshtë referuar "OST") në lidhje me krijimin e një propozimi për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës (më poshtë referuar "GLDPM").
2) Ky propozim (më poshtë referuar "Propozimi CGMM") merr parasysh parimet e përgjithshme dhe objektivat e përcaktuara në Rregulloren e Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një udhëzues mbi alokimin afatgjate të kapaciteteve (më poshtë referuar "Rregullorja 2016 / 1719 "), si dhe Rregulloren (KE) Nr 714/2009 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 13 korrik 2009 mbi kushtet për aksesin në rrjet për shkëmbimet ndërkufitare të energjisë elektrike (më poshtë referuar si" Rregullorja (KE) No 714/2009"). Qëllimi i Rregullores 2016/1719 është koordinimi dhe harmonizimi i llogaritjes së kapaciteteve dhe alokimin ne avancë ne tregjet ndër-rajonale. Për të lehtësuar këto synime, është e nevojshme për të gjithë OST-t të përdorin një model të përbashkët të rrjetit. Një model i përbashkët i rrjetit mund të krijohet vetëm nëse te gjitha OST-t do të kenë akses në të dhënat e gjenerimit dhe ngarkesës. “Gjenerimi” përfshin të gjitha injektimet në rrjetin e transmetimit dhe “Ngarkesa” përfshin të gjitha tërheqjet nga rrejti i transmetimit.
3) Ndërsa metodologjia GLDPM përshkruar në Propozimin GLDPM përcakton kërkesat në lidhje me dorëzimin e të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës të nevojshme për të krijuar modelin e përbashkët, rregullat per krijimin e një modeli të përbashkët të rrjetit janë trajtuar në metodologjine e modelit të përbashkët të rrjetit në pajtim me nenin 18 të Rregullores 2016/1719.
4) Neni 16 i Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të 24 korrikut 2015 krijimin e një udhëzim mbi alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestionit (më poshtë referuar si "Rregullorja 2015/1222") i është referuar në nenin 17 të Rregullores 2016/1719 dhe përcakton disa kërkesat specifike që Propozimi GLDPM

duhet të marrë në konsideratë:

1. Jo më vonë se 10 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, gjithë OST –t bashkërisht do të zhvillojnë një propozim për metodologjinë të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës të nevojshme për ndërtimin e modelit të përbashkët te rrejtit. Propozimi do t'i nënshtrohet konsultimeve në përputhje me nenin 12. Propozimi duhet të përfshijë një arsyetim bazuar në objektivat e kësaj Rregulloreje për të kërkuar informacionin.

2. Propozimi për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës do të specifikojë cilat njësi gjenerimi dhe ngarkese duhet të ofrojnë informacjon në OST-t përkatëse me qëllim llogaritjen e kapaciteteve.

3. Propozimi për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës duhet të specifikojë të dhënat që do të ofrohen nga njësitë gjeneruese dhe ngarkesa për të OST-t. Informacioni duhet të paktën të përfshijë sa vijon: (a) informacion në lidhje me karakteristikat e tyre teknike; (B) informacione lidhur me disponueshmëri e njësive gjeneruese dhe ngarkesave; (C) informacione lidhur me programin e njësive gjeneruese; (D) informacion tjetër përkatës në lidhje me menyren e dispaçimit të njësive gjeneruese.

4. Metodologjia do të specifikojë afatet që do të aplikohen për njësitë gjeneruese dhe ngarkesat për të siguruar informacionin e përmendur në paragrafin 3.

5. Çdo OST do të përdorë dhe të ndajnë me OST-të e tjera informacionin e përmendur në paragrafin 3. Informacioni i referuar në paragrafin 3 (d) do të përdoret vetëm për qëllime të llogaritjes kapacitet.

6. Jo më vonë se dy muaj pas miratimit të metodologjisë së të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës nga të gjitha entet rregullatore, ENTSO-E do të publikojë: (a) listen e subjekteve që u kërkohet të ofrojnë informacion për OST-t; (B) listen e informacionit që u kërkohet të ofrojnë përmendur në paragrafin 3; (C) afatet për ofrimin e informacionit ".

5) Neni 17 i Rregullores 2016/1719 përbën bazën ligjore të propozimi për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës për periudha afatgjata dhe përcakton disa kërkesa shtesë:

1. Jo më vonë se gjashtë muaj pas miratimit të metodologjisë të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës per periudhën - dite në avancë dhe brenda ditës, të përmendura në nenin 9 (6) të Rregullorja e Komisionit (BE) 2015/1222, të gjithë OST do të zhvillojë së bashku një propozim për një metodologjie të vetme të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës e nevojshme për krijimin e modelit të bashkuar të rrjetit për periudha kohore afatgjatë. Metodologjia duhet të jetë objekt i konsultimeve në përputhje me nenin 6. Mtodologjia duhet të marrë parasysh dhe të plotësojë metodologjinë e ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës ne pajtim të nenit 16 të Rregullores (BE) 2015/1222.

2. Per zhvillimin e metodologjisë të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, do të zbatohen kërkesat e përcaktuara në nenin 16 të Rregullores (BE-së) 2015/1222.

6) Neni 2 (2) i Rregullores 2015/1222 përcakton modelin e përbashkët e rrjetit si:
"Një bashkimi gjerë të dhënash, rënë dakord ndërmjet OST-ve të ndryshme që përshkruan karakteristika kryesore të sistemit energjitik (gjenerim, ngarkesë dhe topologji rrjeti) dhe rregullat për ndryshimin e këtyre karakteristikave gjatë procesit të llogaritjes së kapaciteteve"

7) Neni 2 (1) të Rregullores 2015/1222 përcakton modelin individual rrjetit si:
"Grupi të dhënash që përshkruan karakteristikat e sistemit të energjisë (gjenerim, ngarkesë dhe topologji rrjeti) dhe rregullat e lidhura për të ndryshuar këto karakteristika gjatë llogaritjes së kapaciteteve, përgatitur nga OST-t përgjegjës, që të bashkohen me modelet e tjerë individualë të rrjetit për të krijuar modelin e përbashkët e rrjetit".

8) Neni 19 i Rregullores 2015/1222 përfshin gjithashtu dispozitat përkatëse:
2. Çdo modeli individual i rrjetir duhet të përfaqësoje parashikimin më të mirë të mundshme të kushteve të sistemit të transmisionit për çdo skenar të specifikuar nga OST-t në kohën kur modeli individual rrjetit është krijuar.
3. Modelet individuale rrjetit do të marrin parasysh të gjitha elementet e rrjetit të sistemit të transmisionit që janë përdorur në analizat rajonale te sigurise se operimit për periudhën kohore të dhënë.
5. C'do OST do të sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme në modelin individual të rrjetit për të lejuar rrjedhjen e fuqisë aktive dhe reaktive dhe analizat e tensionit në gjendje statike.

9) Neni 4 (8) i Rregullores 2016/1719 përcakton dy detyrime të mëtejshme:
"Propozimi për termat dhe kushtet ose metodologjitë duhet të përfshijë një grafik kohor të propozuar për zbatimin e tyre dhe një përshkrim të ndikimit të tyre të pritshme mbi objektivat e kësaj rregulloreje."

10) Nenet 28 (1) dhe (2) të Rregullores 2015/1222 të përmendur në nenin 22 të Rregullores 2016/1719 formulon formulon detyrimet shtesë për Propozimi GLDPM në adresë të njësive gjeneruese dhe ngarkesave si ofrues të dhënash:

1. *"Për çdo periudhe të llogaritjes së kapacitetit përmendur në nenin 14 (1), secili njësi gjeneruese ose ngarkese subjekt i nenit 16 do të sigurojnë të dhënat e specifikuara në metodologjinë e ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës për OST përgjegjës për zonen përkatëse të kontrollit brenda afateve të përcaktuara.*
2. *Çdo njësi gjeneruese ose ngarkese që ofron informacion në përputhje me Nenin 16 (3) duhet të dorëzojë grupin më i besueshëm të mundshme të të dhënave".*

11) Neni 4 (8) i Rregullores 2016/1719 kërkon që ndikimi i pritshëm i Propozimit GLDPM në objektivat e Rregullores 2016/1719 të jetë i përshkruar. Ndikimi është paraqitur më poshtë (pikat (12) deri (20) të këtij Seksionit).

Përshkrimi i ndikimit të Propozimit GLDPM në objektivat e Rregullores 2016/1719 duhet të lexohet së bashku me nenet përkatëse të Metodologjisë së modelit të përbashkët te rrejtit kërkuar në përputhje me nenin 18 të Rregullores 2016/1719 të jetë një metodologji shoqërues të Metodologjisë GLDPM. Propozimi GLDPM

kontribuon dhe nuk pengon në asnjë mënyrë arritjen e objektivave të nenit 3 të Rregullores 2016/1719. Në veçanti, Propozimi GLDPM i shërben objektivit të nxitjes të tregut efektiv ndër-kufitare me synimet afatgjata mbrojtëse ndër-kufitare për pjesëmarrësit e tregut (neni 3 (a) të Rregullores 2016/1719) duke kontribuar në llogaritjen e koordinuar të kapacitetit nëpërmjet një metodologjie të përbashkët për përgatitjen e modeleve të veçanta të rrjetit shkrirjen e tyre në modelin e përbashkët pan-evropiane të rrjetit për tregjet afatgjata, që përdoret vetëm në rajonet në rajonet e llogaritjes të kapacitetit, ku analiza e sigurisë është aplikuar në bazë të skenarëve të shumta në pajtim me nenin 10 të Rregullores 2016/1719.

12) Në pajtim me nenin 3 (b) të Rregullores 2016/1719, dhe duke marrë parasysh metodologjitë që do të zhvillohet sipas Rregullores 2016/1719 për llogaritjen e kapaciteteve, krijimi i modelit të përbashkët të rrjetit dhe përdorimin e tij në procesin e llogaritjes së kapaciteteve për alokimin afattgjatë, të përdorura vetëm në rajonet e llogaritjes të kapacitetit, ku analiza e sigurisë është aplikuar në bazë të skenarëve të shumta në pajtim me nenin 10 të Rregullores 2016/1719, do të optimizojë llogaritjen dhe alokimin e kapaciteteve ndër-rajonale, nëpërmjet metodologjisë dhe inputeve të njëjtë për përgatitjen e modeleve të veçanta të rrjetit dhe shkrirjen e tyre në modelin e përbashkët të rrjetit pan-evropian. Propozimi i GLDPM kontribuon në përmbushjen e këtij objektivi të Rregullores 2016/1719 duke përshkruar inputet e kërkuara për të lehtësuar përgatitjen e modeleve individuale të rrjetit që do të futen në modelin e përbashkët të rrjetit pan-evropian.

13) Propozimi GLDPM do të sigurojë që objektivi i trajtimit të drejtë dhe jo-diskriminues i OST-ve, NEMOS, Agjencive, autoriteteve rregullatore dhe pjesëmarrësve tregut është përmbushur aq sa kërkesat në lidhje me ofrimin e të dhënave për Propozimin GLDPM janë të njehësuara dhe të detyrueshme në të gjithë EU. Propozimi GLDPM, në përcaktimin e kërkesave për ofrimin e të dhënave për të lehtësuar funksionimin e CGMM në përputhje me nenin 18 të Rregullores 2016/1719, kontribuon në objektivin e të drejtes jo-diskriminuesepër për sigurimin e kapacitetit afat-gjatë ndër-rajonal (Neni 3 (c) i Rregullores 2016/1719).

14) Metodologjia CGM siguron dhe rrit transparencën dhe besueshmërinë e informacionit më tej në Nenin 3 (f) të Rregullores 2016/1719 duke ofruar për monitorim treguesit e cilësisë dhe ofrimin në kohë të të thënave për OST-t. Kërkesat e detajuara në lidhje me ofrimin e të dhënave në Propozimin GLDPM rrisin besueshmërinë e të dhënave që do të jenë në dispozicion të OST-ve për qëllim të krijimit të modeleve individuale të rrjetit dhe krijimin e modelit të rrjetit të përbashkët (për tregjet afatgjata, përdorur vetëm në rajonet në rajonet e llogaritjes të kapacitetit, ku analiza e sigurisë është aplikuar në bazë të skenarëve të shumta në pajtim me nenin 10 të Rregullores 2016/1719).

15) Propozimi GLDPM gjithashtu kontribuon në objektivin e respektimit e nevojës për alokimin afatgjatë të kapaciteteve në mënyrë të ndershme (Neni 3 (e) i Rregullores 2016/1719) përmes ofrimit të një modeli të përbashkët të rrjetit që do të përdoret në procesin e llogaritjes së kapaciteteve në bazë të modelit të rrjetit të përbashkët (për tregjet afatgjata, përdorur vetëm në rajonet në rajonet e llogaritjes të kapacitetit, ku analiza e sigurisë është aplikuar në bazë të skenarëve të shumta në

pajtim me nenin 10 të Rregullores 2016/1719).
16) Propozimi GLDPM do të kontribuojë në funksionimin efikas afatgjatë dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe sektorit të energjisë elektrike në EU duke nxjerrë në pah kërkesat e përbashkëta në lidhje me ofrimin e të dhënave që do të përdoren si input për krijimin e modelit të përbashkët të rrjetit që do të përdoret në mënyrë të koordinuar në të gjithë EU (për tregjet afatgjata, përdorur vetëm në rajonet në rajonet e llogaritjes të kapacitetit, ku analiza e sigurisë është aplikuar në bazë të skenarëve të shumta në pajtim me nenin 10 të Rregullores 2016/1719). (Neni 3 (g) i Rregullores 2016/1719).
17) Propozimi GLDPM kontribuon në objektivin e të drejtes jodiskriminuesepër për sigurimin e kapacitetit afat-gjatë ndër-rajonale (Neni 3 (c) të Rregullores 2016/1719) përsëri duke specifikuar kërkesat e përbashkëta të ofrimit të të dhënave që përbëjnë bazën për ofrimin e modelit të rrjetit të përbashkët (për tregjet afatgjata, përdorur vetëm në rajonet në rajonet e llogaritjes të kapacitetit, ku analiza e sigurisë është aplikuar në bazë të skenarëve të shumta në pajtim me nenin 10 të Rregullores 2016/1719). (Neni 3 (g) i Rregullores 2016/1719).
18) Neni 16 (1) i Rregullores 2015/1222 të cilit i referohet neni 17 i Rregullores 2016/1719 kërkon që një arsyetim bazuar në objektivin e rregullores për të kërkuar informacionin të përfshihet në këtë propozim. Është theksuar se Propozimi i GLDPM në përgjithësi përputhet me objektivat e Rregullores 2016/1719 në atë që informacioni që kërkohet kontribuon në formimin e modelit të përbashkët të rrjetit, në përputhje me kërkesat e përshkruara në Metodologjinë e Modelit të Përbashkët te Rrjetit siç kërkohet në Nenin 18 i Rregullores 2016/1719. Informacioni që duhet të sigurohet për Propozimin GLDPM përbën inputet e kërkuara nga OST-të për të përgatitur modelet e tyre individuale të rrjetit më tej në metodologjinë e modelit të përbashkët te rrejtit të përmendur më sipër. Duke qënë se Propozimi GLDPM pengon raportimin e dyfishtë të informacionit, kërkesat për sigurimin e informacionit janë të balancuara dhe proporcionale. Propozimi gjithashtu lejon ofrimin e të të dhënave sipas mekanizmave ekzistues në juridiksionet individuale anembanë EU.

Dorëzojnë këto Propozim GLDPM për ERE:

Neni 1
Lënda dhe fushëveprimi

1. Metodologjia e ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, përshkruar në këtë propozim është propozimi i përbashkët i të gjitha OST-ve në përputhje me nenin 17 të Rregullores 2016/1719.
2. Kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST në zonën e përmendur në nenin 1 (2) të Rregullores 2016/1719.
3. Kjo metodologji zbatohet gjithashtu për ato juridiksione jashtë zonës së referuar në Nenin 1 (2) të Rregullores 2016/1719, OST-të e të cilave i janë bashkuar procesit CGM në baza vullnetare në përputhje me dispozitat e Nenit 1 të

Metodologjisë së Modelit të Përbashkët te Rrjetit.

4. OST-të e përmendura në paragrafin 1 do të monitorojnë që në ato juridiksione që marrin pjesë në procesin e CGM në baza vullnetare në pajtim me paragrafin 3, të gjitha palët përkatëse respektojnë detyrimet e tyre.Nëse palët përkatëse 3 nuk respektojnë detyrimet thelbësore duke rrezikuar zbatimin dhe funksionimin e Rregullores 2016/1719, i OST-t e referuar në paragrafin 1 do të ndërpresë pjesëmarrjen vulnetare të OST-ve në procesin CGM në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 4(2) të Rregullores 2016/1719.

5. Kjo metodologji nuk zbatohet për lidhjet HVDC që operohen nga një OST nëse vendi anëtar korrespondues ka caktuar përgjegjës për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në nenin 17 të Rregullores 2016/1719 një OST tjetër.

Neni 2
Përkufizimet dhe interpretimi

Dhënave të Gjenerimit dhe Ngarkesës e në pajtim me nenin 16 të Rregullores 2015/1222.

Neni 3
Parime të përgjithshme

1.Kjo metodologji përcakton të dhënat e gjenerimit dhe ngarkesës të cilat mund të kërkohen nga OST-të për të krijuar modelin e përbashkët të rrjetit. Secili OST ka të drejtë, por jo detyrimin për të marrë këto të dhëna nga zotëruesi i elementit përkatës të rrjetit ose pala përgjegjëse për sigurimin e informacionit, sipas rastit, me kusht që të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) OST kërkon të dhënat për të ndërtuar modelin e vet individual të rrjetit ose të përmbushë detyrimet e tjera që janë të nevojshme për krijimin e modelit të përbashkët të rrjetit; grupi i të dhënave të kërkuara duhet të jetë grupi minimal që i mundëson OST-së ta bëjë këtë;
b) të dhënat nuk janë në dispozicion të OST
    i. ose në bazë të legjislacionit ose rregullave kombëtare, në baza kontraktuale ose bazuar në ndonjë lloj tjetër mekanizmi ligjërisht detyrues;
    ii. ose si të dhëna të disponueshme nëpërmjet platformës qëndrore të transparencës së informacionit në përputhje me Rregulloren e Komisionit (BE) nr. 543/2013 të datës 14 qershor 2013 për ofrimin dhe publikimin e të dhënave në tregjet e energjisë elektrike dhe ndryshimin e Aneksit I në Rregulloren (KE) nr. 714/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (më poshtë referuar: "Rregullorja 543/2013") ose në pajtim me Rregulloren (EU) nr. 1227/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 25 tetor 2011 integritetit të tregut të energjisë dhe transparencës (më poshtë referuar si "Rregullorja 1227/2011 (REMIT)").

2.Kjo metodologji nuk u jep OST-ve të drejtën për të kërkuar të dhëna që nuk janë

përshkruar në mënyrë të qartë në këtë metodologji. Për shmangien e pasigurive, të dhënat që nuk përdoren për të ndërtuar modelet indviduale të rrjetit për periudha afatgjata janë jashtë fushëveprimit të metodologjisë aktuale.

3. Kërkesa për harmonizim përcaktuar në Nenin 19 (4) të Rregullores 2015/1222 referuar Nenit 20 të Rregullores 2016/1719 kuptohet që i referohet harmonizimit të parimeve të modelimit. OST-t nuk do t'u detyrohen kërkesave për harmonizim për të marrë të dhëna të cilat ata i kanë te nevojshme për ndërtimin e modelit individual ose për të përmbushur detyrimet e tjera që janë thelbësore për krijimin e modelit të rrjetit të përbashkët.

4. Përveç rasteve kur është shprehur ndryshe, zotëruesi i elementit përkatës të rrjetit është pala që i kërkohet të sigurojë të dhënat për OST.

5. Të dhënat që do t'i ofrohen OST-së sipas kësaj metodologjie, në parim, duhet t'i ofrohen direkt OST-së. Në bazë të marrëveshjes së OST, palët që kërkohen të sigurojnë të dhëna sipas metodologjisë të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës do të lejohen të delegojnë detyrat në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 62 të Rregullores 2016/1719. OST nuk do të pengojë në mënyrë të paarsyeshme marrëveshjen e tij.

6.Në varësi të detyrimeve konfidenciale të përcaktuara në Nenin 7 të Rregullores 2016/1719, OST mundet ndajnë të dhënat e marra me OST-t të tjera që marrin pjesë në procesin e CGM në pajtim me Nenin 16 (3) të Rregullores 2015/1222 referuara Nenit 17 të Rregullores 2016/1719, si dhe operatorët rregullues referuar në Nenin 19 të metodologjisë së modelit të përbashkë të rrjetit, operatorët bashkues përmendur në nenin 20 të metodologjisë së modelit të përbashkë të rrjetit dhe zotëruesit të platformës së informacionit të përmendur në nenin 21 të të metodologjisë së modelit të përbashkë të rrjetit.

7.Lidhur me zbatueshmërinë e metodologjisë aktuale dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në lidhje me dispozitat që përfshijnë zbatimin dhe interpretimin e kësaj metodologjie dhe funksionimim e duhur të procesit të ofrimit të të dhënave aplikohen ligjet përkatëse kombëtare ose të EU.

8.Të gjitha afatet e deklaruara në këtë Propozim GLDPM i referohen afateve të tregut siç përcaktohet në Nenin 2 (15) të Rregullores 2015/1222.

9. Kjo metodologji lidhet vetëm me ofrimin e të dhënave dhe afatet lidhur me procesin e CGM dhe nuk ndikon në detyrimet ekzistuese apo të ardhshme për të siguruar të dhëna ose afatet lidhur me ndonjë proces tjetër të operimit të sistemit, nëse këto detyrime për të siguruar të dhënat ose këto afate bazohen në legjislacionin ose rregullat kombëtare, marrëveshjet kontraktuale, ose ndonjë lloj tjetër mekanizmi ligjërisht detyrues.

Neni 4
Ofrimi i të dhënave

1. Secila palë e detyruar të ofrojë të dhëna sipas kësaj metodologjie do të respektojë rregullat e vendosura nga OST-ja përgjegjëse.

2. Kjo metodologji në lidhje me dispozitat e metodologjisë së modelit të përbashkë të rrjetit të kërkuara sipas nenit 18 të Rregullores 2016/1719 do të

mundësojë krijimin modelit të përbashkë të rrjetit sipas Nenit 22 të Rregullores 2016/1719. Në veçanti, kjo do të thotë se kjo metodologjia ka të bëjë me elementët e rrjetit të tensionit të lartë dhe të tensionit të ekstra të lartë, për aq kohë sa këto përdoren në analizat e sigurisë operative rajonale për periudhat përkatëse.

3. Ku kjo metodologji i referohet një ndarjeje nga burimet primare të energjisë, një ndarje në burime primare të energjisë në përputhje me ato të përdorura nga platforma qendrore e transparencës së informacionit referuar në Nenin 3 të Rregullores 543/2013.

Neni 5
Operatoret e sistemit të shpërndarjes dhe atyre të mbyllura të shpërndrarjes - të dhënat strukturore

1. Operatoret e sistemit të shpërndarjes dhe atyre të mbyllura të shpërndrarjes duhet të sigurojnë të dhënat strukturore të përshkruara në paragrafin 2 të këtij neni, nëse këto elemente të rrjetit i përkasin nivelit të tensionit:
   a) 220 kV ose më lart;
   b) prej më pak se 220 kV dhe elementet e rrjetit të cilat përdoren në analizat rajonale të sigurisë operative.
2. Elementet e përkatës të rrjetit dhe të dhënat që duhet të sigurohen për to janë
   a) nën-stacionet: nivelet e tensionit, seksionet e zbarrave dhe nëse është e aplikueshme modelimi i pajisjeve komutuese, lloji çelsave, thikave, izolatorëve dhe celsave te ngarkesës;
   b) linjat ose kabllot: karakteristikat elektrike, nën-stacionet në të cilat janë të lidhura;
   c) transformatorëve të fuqisë: karakteristikat elektrike, nën-stacionet ku janë të lidhur, lloji i ancafkave, dhe llojin e rregullimit ku është e mundur;
   d) paisjet e kompensimit të fuqise dhe sistemet e transmetimit fleksibël AC (FACTS): tipi, karakteristikat elektrike, dhe llojin e rregullimit ku është e mundur.
3. Operatoret e sistemit të shpërndarjes dhe atyre të mbyllura të shpërndrarjes duhet të sigurojnë një model apo një model ekuivalent të atyre pjesëve të rrjetit që operojnë në tension më të vogël se 220 kV nese:
   a) këto pjesë të rrjetit kanë elemente të përdorur në analizat e sigurisë operative rajonale ose,
   b) elementet përkatëse te rrjetit idhin:
      i. një njesi gjenerimi ose ngarkese modeluar në mënyrë të detajuar në përputhje me nenin 8 ose 9 në tension 220 kV apo më të lartë;
      ii. dy nyje në tension 220 kV ose më e lartë.

4. Modelet dhe modelet ekuivalente sipas paragrafit 3 duhet të përmbajnë të paktën agregatët e ngarkesës të vecuara nga gjenerimi dhe kapaciteti gjenerues i vecuara nga burimet primare të energjisë dhe të vecuara nga ngarkesa në pjesët përkatëse të rrjetit të vecuara nga nën-stacionet e modelit ekuivalent ose nënstacionet në të cilat janë lidhur pjesët perkatëse të rrjetit.

5. Operatoret e sistemit të shpërndarjes dhe atyre të mbyllura të shpërndrarjes duhet të ofrojnë informacionin e mëposhtëm mbi limitet e monitorimit operativ për elementet përkatës të rrjetit të përshkruar në këtë nen:

a) një PATL që pasqyron vlerësimet nominale për çdo sezon, nëse vlerësimi nuk varet nga kushtet meteorologjike ose defekteve;

b) jë ose më shumë TATL, për sezonin përkatëse bazuar në PATL në fuqi, për çdo linjë transmetimi të modeluar, kabllo, transformator dhe pajisje DC;

c) për çdo TATL të specifikuar sipas pikës (b), kohëzgjatjen TATL;

d) rrymën e stakimi për çdo pjesë përkatës të pajisjeve transmetuese të modeluar në mënyrë të qartë, nëse ësthë e mundur;

e) lerat maksimale dhe minimale të pranueshme në çdo nivel të tensionit nominal, në bazë të kodeve, standardeve, politikave dhe marrëveshjeve përkatëse në zbatim;

Neni 6
Operatoret e sistemit të shpërndarjes dhe atyre të mbyllura të shpërndrarjes - të dhënat variabël që ndryshjnë rrallë

1. Operatoret e sistemit të shpërndarjes dhe atyre të mbyllura të shpërndrarjes duhet të ofrojnë të dhënat variabël që ndryshojnë rrallë të elementeve përkatës të rrjetit

a) pozicionin e ancafkave në gjithë transformatoret e modeluar përfshirë transformatorët fazë-shifter;

b) pozicionin më të mirë topologjik të parashikuar si konfiguracion i pritshëm i pjesëve përkatëse të rrjetit;

c) Parametrat e komandimit për pikat e mëposhtme të pajisjeve rregulluese të referuara në nenet 5 dhe 8, respektivisht, kur janë të modeluara dhe relevante:

i. ransformatorët e fuqisë dhe ancafkat e tyre;

ii. ransformatorët fazë – shifter dhe ancafkat e tyre;

iii. ajisjet kompenuese të energjisë reaktive:

1. huntet kompensatore;

2. ompensatoret statike VAR;

3. ondesatorët sinkron;
4. ompensatoret statike sinkron (STATCOM) dhe pajisje të tjera fleksibël AC (FACTS);

iv. jeneratorët e pajisur me rregulatorë tensjoni;

d) Parametrat e komandimit sipas pikës (c) duhet të përfshijnë të dhënat e mëposhtme kur është e aplikueshme:

v. jëndja - në punë / jashtë pune;

vi. ënyra e kontrollit - tensjoni, fuqia aktive, fuqia reaktive, faktori i fuqisë, rryma, ose mënyra të tjetëra të aplikueshme;

vii. regullimi i synuar në kV, MW, MVAr, PU, ose njësitë e tjera të përshtatshme;

viii. regullimi i synuar në bandë;

ix. regullimi i faktorit të pjesëmarrjes;

x. yjet balancuese.

Neni 7
Operatoret e sistemit të shpërndarjes dhe atyre të mbyllura të shpërndrarjes - të dhënat variabël

1. Operatoret e sistemit të shpërndarjes dhe atyre të mbyllura të shpërndrarjes duhet të ofrojnë të dhënat variabël të elementeve përkatës të rrjetit të referuara ne nenin 5:

a) mosdisponueshmëria e planifikuar ose të detyruar të elementeve të modeluar;
b) veprimet përmirësuese topologjike në pajtim me Nenin 14 të Rregullores 2016/1719, si dhe masat topologjike të miratuara sipas metodologjisë së modelit të përbashkët të rrjetit.

Neni 8
Gjenerimi - të dhënat strukturore

1.Zotëruesit e njësive gjeneruese, duke përfshirë kondensatorët sinkron dhe pompat, duhet të sigurojnë informacionin përkatës përshkruar në këtë Nen në qofte se janë të modeluara në detaje, qoftë individuale apo së bashku. Njësitë gjeneruese duhet të modelohen në detaje në qoftë se janë të lidhura në një nivel të tensionit

a) 220 kV ose më lart;

b) prej më pak se 220 kV dhe elementet e rrjetit të cilat përdoren në analizat rajonale të sigurisë operative.

2.Njësitë gjeneruese identike apo të ngjashme mund të modelohen në detaje së bashku nëse ky modelim është i mjaftueshëm në analizat rajonale të sigurisë operative. Për njësitë gjeneruese të modeluara në mënyrë të detajuar sëbashku, një model ekuivalent duhet të përfshihen në IGM. Zotëruesit e njësive gjeneruese individuale duhet të sigurojnë informacion të detajuar mbi njësitë gjeneruese dhe OSSh-ja përkatëse duhet të sigurojë informacion të detajuar mbi lidhjet e rrjetit në mënyrë që OST të mund të llogarisë modelin ekuivalent. Në rast të kundërt, OST-së do t'i ofrohet modeli i plotë ekuivalent.

3.Operatoret e sistemit të shpërndarjes përfshi ata të mbyllur të shpërndrarjes, duhet të sigurojë informacionin përkatës të përshkruar në këtë Nen për kapacitetin gjenerues të modeluar jo në detaje. Ky kapacitet gjenerues do të modelohet si tërësi i ndarë nga burimet primare të energjisë dhe ngarkesa.

4.Për njësitë gjeneruese të modeluara në detaje edhe për tërësine e kapacitetit gjenerues të ndarë nga burimet primare të energjisë dhe ngarkesës, duhet të sigurohen të dhënat e mëposhtme:

a) pika e lidhjes;
b) burimi primar i energjisë.

5.Për njësitë gjeneruese të modeluara në mënyrë të detajuar në IGM duhet të përfshihen të dhënat e mëposhtme:

a) vlerat maksimale dhe minimale të fuqisë aktive; përcaktuara si vlera për të cilat njësi gjeneruese mund të rregullohet. Në rastin e pompave hidroelektrike rezervuese, do të modelohen dy cikle dhe dy të dhëna duhet të jenë të jepen, një për të gjenerimin dhe një mënyrën e pompimit;
b) llojin e mënyrës së kontrollit, një nga të mëposhtmet: "jashtë pune", "kontrolli i tensionit", "kontrolli i faktorit te fuqisë", "kontrolli i fuqisë reaktive" dhe, për njësitë gjeneruese me tension të rregullueshëm, nyjet balancuese ku tensioni planifikuar është i vendosur;
c) vlerat maksimale dhe minimale të fuqisë reaktive kur është dhënë vlera minimale dhe maksimale e fuqisë aktive, si dhe, kurbën e aftësisë;
d) ngarkesa ndihmëse e njësisë gjeneruese që përfaqëson nevojat vetiake të njësisë gjeneruese duhet të modelohet si një ngarkesë jo-konform në pikën e lidhjes.

6. Për njësitë gjeneruese modeluar si tërësi në IGM duhet të përfshihen të dhënat e mëposhtme:
   a) Tërësia e kapacitetit gjenerues e veçuar nga burimet primare të energjisë dhe nga ngarkesa në pjesët përkatëse të rrjetit referuara ne Nenin 5 të veçuara nga nën-stacionet e modelit ekuivalent apo nën-stacionet në të cilat janë të lidhura pjesët përkatëse të rrjetit.

7.Për njësitë gjeneruese modeluar si tërësi dhe menaxhuar nga një tërësi të dhënash të cilat janë përdorur në analizën rajonale të sigurisë të operimit duhet të përfshihen të dhënat e mëposhtme:

a) Tërësia e kapacitetit gjenerues e veçuar nga burimet primare të

energjisë dhe nga ngarkesa menaxhuar nga një tërësi të dhënash në pjesët përkatëse të veçuara nga nën-stacionet e modelit ekuivalent apo nën-stacionet në të cilat janë të lidhura pjesët përkatëse të rrjetit.

Neni 9
Gjenerimi - të dhënat variabël që ndryshjnë rrallë

1. Zotëruesit e njësive gjeneruese të modeluara në mënyrë të detajuar ose, në rastin e njësive gjeneruese të modeluara në mënyrë të detajuar së bashku, zotëruesit e njësive gjeneruese individuale duhet të japin të dhënat variabile që ndryshojnë rrallë në vijim për njësitë gjeneruese të referuara në nenin 8:
   a) Kërkesa parësore për dispeçim
2. Informacioni i përmendur në paragrafin (1) (a) përbën informacionin në dispozicion në lidhje me mënyrën se si do të dispaçohen njësitë gjeneruese në përputhje me Nenin 16 (3) (d) të Rregullores 2015/1222, siç referohet në Nenin 17 të Rregullores 2016/1719 dhe do të përdoret vetëm për qëllim të llogaritjes së kapacitetit.

Neni 10
Gjenerimi - të dhënat variabël

1. Zotëruesit e njësive gjeneruese të modeluara në mënyrë të detajuar ose, në rastin e njësive gjeneruese të modeluara në mënyrë të detajuar së bashku, zotëruesit e njësive gjeneruese individuale duhet të japin të dhënat variabile në vijim për njësitë gjeneruese të referuara në nenin 8:
   a) informacion në lidhje me rezervat e sipërmë dhe të poshtme të fuqisë aktive dhe llojet e tjera të sherbimeve ndihmëse;
   b) planin e ndërprerjeve;
   c) lloji i testimit;
   d) padisponueshmëria e planifikuar;
   e) çdo kufizim të kapacitetit të fuqisë aktive;
   f) parashikimi i prodhimit të fuqisë active.
2. Informacioni i përmendur në paragrafin (1) (a) përbën informacionin në dispozicion në lidhje me mënyrën se si do të dispaçohen njësitë gjeneruese në përputhje me Nenin 16 (3) (d) të Rregullores 2015/1222, siç referohet në Nenin 17 të Rregullores 2016/1719 dhe do të përdoret vetëm për qëllim të llogaritjes së kapacitetit.

Neni 11
Ngarkesa - të dhënat strukturore

1.Ngarkesat duhet të sigurojnë informacionin përkatës përshkruar në këtë Nen në qofte se janë të modeluara në detaje, qoftë individuale apo së bashku. Njësitë gjeneruese duhet të modelohen në detaje në qoftë se janë të lidhura në një nivel të tensionit

a) 220 kV ose më lart;
b) prej më pak se 220 kV dhe elementet e rrjetit të cilat përdoren në analizat rajonale të sigurisë operative.

2.Ngarkesa identike apo të ngjashme mund të modelohen në detaje së bashku nëse ky modelim është i mjaftueshëm në analizat rajonale të sigurisë operative. Për ngarkesat e modeluara në mënyrë të detajuar sëbashku, një model ekuivalent duhet të përfshihen në IGM. Zotëruesit ngarkesave individuale duhet të sigurojnë informacion të detajuar mbi ngarkesat dhe OSSh-ja përkatëse duhet të sigurojë informacion të detajuar mbi lidhjet e rrjetit në mënyrë që OST të mund të llogarisë modelin ekuivalent. Në rast të kundërt, OST-së do t'i ofrohet modeli i plotë ekuivalent.

3.Operatoret e sistemit të shpërndarjes përfshi ata të mbyllur të shpërndrarjes, duhet të sigurojë informacionin përkatës të përshkruar në këtë Nen për ngarkesa të modeluar jo në detaje te cilat duhen modeluar si tërësi.

4.Për ngarkesat e modeluara në detaje edhe për tërësine ngarkesave të ndarë nga gjenerimi, duhet të sigurohen të dhënat e mëposhtme:

a) pika e lidhjes;
b) konsumi maksimal i fuqisë active;
c) faktori i fuqisë ose fuqia reactive;
d) Përputhshëria (ku vlera "e vërtetë" nënkupton që konsumi i fuqisë aktive dhe reaktive i ngarkesës duhet të jetë i shkallëzuar kur shkallëzohet ngarkesën e përgjithshme).

5.Për ngarkesat e modeluara në mënyrë të detajuar duhet të ofrohen të dhënat e mëposhtme:

a) karakteristikat e kontrollit të fuqisë reaktive, kur këto janë të instaluara;
b)
uqinë maksimale dhe minimale aktive në dispozicion të kërkesës dhe kohëzgjatjen maksimale dhe minimale të çdo ndërprerje te fuqisë në dispozicion të kërkesës;

6.Për ngarkesat e modeluara si tërësi duhet të ofrohen të dhënat e mëposhtme:

a) Tërësia e ngarkesave e veçuar nga gjenerimi në pjesët përkatëse të rrjetit referuara ne Nenin 5 të veçuara nga nën-stacionet e modelit ekuivalent apo nën-stacionet në të cilat janë të lidhura pjesët përkatëse të rrjetit.

7.Për ngarkesat e modeluara si tërësi dhe menaxhuar nga një tërësi të dhënash të cilat janë përdorur në analizën rajonale të sigurisë të operimit duhet të përfshihen të dhënat e mëposhtme:

a) Tërësia e ngarkesave e veçuar nga gjenerimi e menaxhuar nga një tërësi të dhënash në pjesët përkatëse të veçuara nga nën-stacionet e modelit ekuivalent apo nën-stacionet në të cilat janë të lidhura pjesët përkatëse të rrjetit.

Neni 12
Ngarkesa - të dhënat variabël

1. Zotëruesit e ngarkesave të modeluara në mënyrë të detajuar ose, në rastin e ngarkesave të modeluara në mënyrë të detajuar së bashku, duhet të japin të dhënat variabile në vijim për ngarkesat të referuara në nenin 11 kur është e mundur:
   a) planin e ndërprerjeve;
   b) parashikimi i fuqisë aktive në dispozicion të kërkesës dhe çdo përgjigje të planifikuar ndaj kërkesës;

Neni 13
Lidhjet HVDC - të dhënat strukturore

1. Lidhje HVDC do të modelohen pavarësisht nëse janë të vendosura tërësisht brenda një zone të vetme ofertuese apo lidhi dy zona ofertuese. OST ose OST-t e interesuar do të vendosin për shkallën e detajeve me të cilën duhet të modelohet lidhja HVDC. Ata duhet të bazojnë vendimin e tyre mbi funksionet për të cilat do të përdoret lidhja HVDC. Si parazgjedhje, një lidhje HVDC do të modelohet në mënyrë të detajuar dhe pjesët AC/DC e lidhjes HVDC do të shkëmbehen nga OST-t në fjalë, pavaresisht se funksionet per te cilat do të përdoret nuk e kërkojnë këtë.
2. Për lidhjet HVDC modeluar në mënyrë të detajuar dhe për ata modeluar në një mënyrë të thjeshtëzuar, duhet të përfshihen të dhënat në vijim:
   a) Pika e lidhjes.
3. Për lidhjet HVDC të modeluara në detaje zotëruesi duhet të ofrojë një model të detajuar që do të përfshijë
   a) karakteristikat elektrike
   b) lloji dhe karakteristikat e mënyrave të komandimit.
4. Lidhjet HVDC të modeluara në mënyrë të thjeshtuar, do të përfaqësohen nga flukse ekuivalente në pikën e lidhjes.

Neni 14
Lidhjet HVDC - të dhënat variabël që ndryshjnë rrallë

1.Zotëruesit e lidhjeve HVDC të modeluara në mënyrë të detajuar duhet të japin të dhënat variabile që ndryshojnë rrallë për lidhjet HVDC të referuara në Nenin 13:
   a) Parametrat e komandimit përfshi:
      i. regjimin e punës - inverter / ndreqës;
      ii. mënyra e kontrollit - tensjoni, fuqia aktive, fuqia reaktive, faktori i fuqisë, rryma, ose mënyra të tjetëra të aplikueshme;
      iii. tensioni i synuar;
      iv. nyjet balancuese

Neni 15
Lidhjet HVDC - të dhënat variabël

1.Zotëruesit e lidhjeve HVDC të modeluara në mënyrë të detajuar duhet të japin të

dhënat variabile për lidhjet HVDC të referuara në Nenin 13 nëse është e mundur:

a) fuqia aktive e synuar;

Neni 16
Afatet për ofrimin e informacionit

1.Afatet e paracaktuara për sigurimin e informacionit sipas llojit të të dhënave janë si më poshtë:

a) të dhënat strukturore: gjashtë muaj para hyrjes në veprim apo zbatimit të një ndryshimi në karakteristikat e elementit përkatës të rrjetit; vlefshmëria e të dhënave të ofruara duhet të konfirmohet çdo vit deri më 01 Prill;
b) të dhënat variabël dhe ato që ndryshjnë rrallë:
   i. ndryshimet e pritshme për vitit vijues duhet të njoftohen në OST jo më vonë se data 01 Prill e çdo viti;
   ii. ndryshimet e pritshme për muajin në vijim duhet të njoftohen në OST jo më vonë se dita e pestë e çdo muaji;

2.Kur cakton afatet për ofrimin e të dhënave, secili OST mund të caktojë një afat që është më pak kufizues për ofruesit e të dhënave sesa afati i përcaktuar në paragrafin 1. Kur një OST ka caktuar afatin më pak kufizues se afati i paracaktuar dhe me vone e ndryshon kete afat në një më të kufizuar, OST do të sigurojë që parimet e përshkruara në Rregulloren 2016/1719 në aspektin e konsultimit të palëve të interesuara ose në alternativë, të sigurojë që zhvillohen procese të mjaftueshme konsultimi dhe aprovimi për të përmbushur kërkesat në nivel kombëtar, me kusht që qasja e tillë alternative të jetë në përputhje me parimet e përgjithshme të konsultimit të palëve të interesuara të përcaktuara në Rregulloren 2016/1719. Në asnjë rrethanë, OST-t nuk përcaktojnë afate kohore më të kufizuara për ofruesit e të dhënave sesa afatet e paracaktuara sipas kësaj metodologjie.

Neni 17
Monitorimi i cilësisë

1.Secili OST do të monitorojë cilësinë e të dhënave që i janë dhënë, si dhe afatin kohor të dorëzimit të të dhënave dhe pajtueshmërinë e plotë me rregullat e zbatimit.
2.Nëse një OST identifikon probleme në lidhje me cilësinë e të dhënave që i janë ofruar ose kohëzgjatjen e dhënies së të dhënave ose pajtueshmërinë e përgjithshme me rregullat e zbatimit, në radhë të parë do të përpiqet të zgjidhë këto probleme direkt me subjektin në fjalë.

Neni 18
Afati kohor i zbatimit

1.

as miratimit të metodologjisë së tanishme secili OST do të publikojë atë në internet, në përputhje me nenin 4 (13) të Rregullores 2016/1719.

2.

o më vonë se një muaj pas miratimit të metodologjisë aktuale, secili OST do të:

a) nformojnë entitetet që duhet të ofrojnë të dhëna mbi informacionin që duhet të ofrojnë, si dhe afatet për sigurimin e informacionit;

b) ërcjellë informacionin e përcaktuar në (a) tek ENTSO-E;

